



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-41330 /24

Klinë, dt 10.12 /24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 29.10.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së dhe prezantoi rendin e ditës.

1. *Organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfetar;*
2. *Siguria në trafik;*
3. *Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje;*
4. *Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit;*
5. *Të ndryshme.*

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Përshëndetje për të gjithë! Po besoj që, në mungesë të mikrofonit, salla është në heshtje dhe që sado-kudo dëgjohemi. Koordinatorja do të mundohet që kushdo që e merr fjalën, ta përcjellë mikrofonin dhe s'besoj që do të kemi telashe. Shfrytëzoj rastin t'ju përshëndes të gjithëve! Përshëndes togerin, Besnik Qupeva, drejtorin e DKA-së, Qemajl Sejdija, Klerët, KFOR-in, OSBE-në, UNMIK-un, përshëndetje të veçantë për FSK-në, zyrtarët dhe ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarjen e vazhdueshme dhe uroj që edhe ky takim të kalojë ashtu si çdo takim tjetër produktiv! Koordinatorja e ka shpërndarë procesverbalin dhe materialin e nevojshëm për këtë takim.

Pika 1. *Organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërfetar.*

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Po e përsëris prapë që të gjitha temat që i kemi në KKSB janë nga plani i përgjithshëm. Ne kemi paraparë disa strategji për të cilat do të ju tregoj se çfarë forme kemi ndjekur deri tanë dhe çka kemi planifikuar për të ardhmen.

Nën një është organizimi i aktiviteteve sportive. Ky aktivitet nuk ka dal nga Këshilli për Siguri në Bashkësi, sepse grupet ndërfetare ose anëtarët bëjnë takime sportive para se të jetë kjo temë në Këshillin për Siguri në Bashkësi. Këtë informatë e kanë të gjithë, jo vetëm unë, dhe kjo është një traditë që në komunën tonë ka aktivitete të tillë sportive që zhvillohen ndër vite. Pjesa tjeter se sa bashkëngjiten ajo mbetet çështje tjeter, mirëpo se diçka e tillë ndodh në komunën tonë kjo është shumë reale që ndodh së paku një herë në vit që organizohen takime sportive. Eventet kulturore ku pjesëmarrësit mund të ndajnë tradita dhe zakone duke krijuar një atmosferë të hapur dhe respektuese, vitin e kaluar kemi pasur 16 -ditëshin e aktivizimit kundër dhunës në familje dhe së bashku me zyrtaren për komunitete dhe kthim kemi organizuar aktivitet ku gratë e minoriteteve kanë prezantuar traditën e tyre te ushqimeve. Kjo është një diçka që në komunën tonë ka ndodhur dhe jam e sigurt që aktivitete të tillë do të ndodhin edhe në të ardhmen në komunën tonë. Diskutimi në panel ku të ftuarit në grupe të ndryshme mund të flasin për rëndësinë e tolerancës dhe bashkëjetesës.

Nëse dikush ka diçka për të shtuar në pikën e parë, le të urdhërojë, përndryshe mund të vazhdojmë me pikën e dytë. Një kërkim falje e kemi prapë për Silvijan për shkak të përkthimit që tash e disa takime e kemi të njëjtin problem, por që mundësi tjera nuk kemi.

Z.Jeton Sokoli: Përshëndetje nënkyetare dhe të gjithë të pranishmit! Shumicën prej ideve të aktiviteteve ndëretnike dhe ndërfetare i përmende, kështu që, unë s'po e përmendi aktivitetin sportiv, por do të ishte mirë që të kemi një forum më drejtues fetar ose një panel ku do të ishte një diskutim rrëth temave të ndryshme; rrëth tolerancës, rrëth harmonisë fetare, ndërfetare në qytetin e Klinës. Nuk e di për kolegët e mi të besimeve të tjera, por besoj që do të ishte e mirëseardhur, edhe pse besoj që nuk kemi telashe dhe nuk kemi mungesë të tolerancës dhe mungesë të harmonisë. Unë jam shumë i hapur për një panel diskutimi të tillë. Po ashtu, do të ishte e udhës të përmendim ndonjë festival të kulturave dhe traditave ndëretnike në qytetin e Klinës.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë! Dëshirat dhe mundësitë janë dy çështje që janë të diskutueshme; ne me të vërtetë përkrahim çdo iniciativë. Panelet e llojeve të ndryshme të aktiviteteve, qofshin kulturore, qofshin të ushqimeve, duhet të kenë një mbështetje dhe ne kryesisht shkojmë me organizata, sepse komuna nuk e ka paraparë në buxhetin e vet diçka të tillë. Kështu që, nëse na jepet mundësia, do ta shfrytëzojmë, pse jo? Dhe në aktivitetin e 16-diteshit të aktivizimit kundër dhunës në familje jeni të ftuar të gjithë dhe pse jo atë aktivitet mund ta bëjmë më madhështor nëse do ta kemi mbështetjen e ndonjë organizate. Ne mund ta bëjmë një aktivitet shumë të fuqishëm, ani pse mund që të mos ketë një dreke ose një shëtitje.

Z. Jeton Sokoli: Vet fakti që kemi në agjendë një diskutim të tillë dhe kemi diskutuar edhe në

takimin e kaluar që, midis temës që kemi në letër, do të ishte mirë që të kemi edhe veprime. Unë e di që ka pasur veprime në të kaluarën dhe do të ketë veprime nga KKSB-ja por do të ishte mirë të kemi synime për të vepruar diçka ndoshta me shpenzime minimale.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Pikërisht kjo është që unë po e ndaj si temë me ju dhe e pres ndihmën e juaj. Jeni katër përfaqësues fetarë të cilët bashkë do të kishit mundur të organizoni diçka shumë të mirë për të gjithë, dhe ne sigurisht kishim dhënë kontributin tonë. Ne jemi të gatshëm të mbështesim çdo iniciativë.

Hoxhë, z.Fitim Boja: Nënkyetare, përshëndetje për ty dhe të gjithë në sallë! Aktivitetet që i përmende ti nuk janë vetëm një vit apo dy vite, por janë me dekada që i organizojmë. Pak tash jemi ndalur, se edhe mosha pak po e bën të veten. Mirëpo, ne, çdo ditë jemi në panel dhe çdo ditë jemi në tribuna, sepse vetëm shfaqja e jonë e tregon harmoninë, kulturën, traditën, bashkëpunimin, bashkëjetesën e të gjitha këtyre.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, hoxhë! Nuk është asnjëherë e tepërt me diskutu e me thënë. Unë jam e sigurt që ju të katërt mundoheni me tregu secili më të mirën e juaj për besimtarët tuaj dhe e bëni më të mirën e mundshme. Esenca e kësaj është që të gjithë të jemi bashkë në një vend.

Don Jeton Thaqi: Përshëndetje për të gjithë! Tash ndoshta po i bie të përsëris disa gjëra; ato aktivitete sportive që janë bërë në mes të priftërinjve dhe hoxhallarëve kanë qenë aktivitete sportive shumë të mira, sepse qëllimi ka qenë të përçojmë një mesazh pozitiv tek populli. Besoj që është mirë që përvèç aktiviteteve sportive të bëjmë edhe ndonjë aktivitet tjeter për të përçuar një mesazh të mirë tek besimtarët, sepse kur ata na shohin që ne jemi bashkë, atëherë sigurisht që ndikon pozitivisht.

Unë e kam parë që edhe në nivelin e Kosovës ka qenë më shumë KFOR-i ose organizatat ndërkombëtare që kanë organizuar takime formale në mes të udhëheqësve fetarë, ndërsa ata vetë më lehtë janë takuar në ndonjë kafe. Ne nuk kemi me asnjerin problem të takohemi, të pimë kafe ose të rrjmë, por diçka kështu formale e kemi më problem të organizojmë. Besoj që duhet të mësohem i edhe të bëjmë një gjë të tillë, të dialogojmë, të ndajmë vështirësitë dhe problemet, por edhe të mirat që i gjëzojmë së bashku.

Ndërsa sa i përket komunës, nëse nuk ka sivjet fonde, mund të parashikohet për vitin e ardhshëm nëse e sheh që është diçka e rëndësishme dhe ndikon mirë për gjithë popullatën.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit, don Jeton! Vet fakti që brenda një komune si çdo komunë tjeter që e kanë Këshillin për Siguri në Bashkësi ku janë të gjithë akterët kryesor nga të gjitha institucionet, kjo ndodhë edhe në Këshillin për Siguri në Bashkësi. Duhet të gjithë të bashkëngjitemi. Shfrytëzoj rastin të përmend aktivitetin e muajit tetor, muajin rozë për kancerin e gjirit. Shumë pak janë aktiv, sado që ne si komunë po mundohemi të kemi aktivitete.

Jo vetëm pjesa e institucioneve fetare por edhe pjesa tjetër e organizatave joqeveritare që janë të thirrura nuk marrin pjesë. Realisht, të themi nuk marrin pjesë as anëtarët e asamblesë komunale dhe gjithë organizimet që bëhen brenda komunës mbesin pak të zbehta sepse nuk marrim përkrahje të masës.

Hoxhë, z. Fitim Bojaj: Nënkyetare, me të thënë të drejtën, ne nuk kemi ftesa asnjëherë për këto lloj organizimesh. Mbahen organizime të ndryshme nga komuna e Klinës, por ne si komunitet fetar, si Bashkësi Islame, asnjëherë nuk kemi ftesa, sa inaugurimi bëhet, sa shkolla hapet, sa dita e shkollës mbahet. Tash për muajin rozë keni organizuar, ne jemi qytetarë të këtij vendi, por ftesë nuk kemi asnjëherë. Ne kemi ftesë vetëm për 17 Shkurt dhe 28 Nëntor, ndoshta këta të tjërët kanë, por ne jo!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: E kuptoj, me të drejtë.

Don Jeton Thaqi: Unë s'kam pasur ftesë as për këto dy organizime që janë bërë! E konfirmoj atë çka e thotë hoxha.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: E kuptoj shumë, hoxhë, vërejtje me vend! Jam e befasuar në një mënyrë, jo që unë jam përgjegjëse për ftesat, por faktikisht jam pjesë e këtij gabimi. Edhe pse unë kur kam qenë drejtoreshë shkolle, në çdo organizim që kemi pasur, kemi ftuar klerët fetarë dhe KFOR-in. Tash ndoshta kanë ndryshuar gjërat me kalimin e kohës, por është një vërejtje me vend, hoxhë! Dhe unë prej tash, jo vetëm ju të katërt që jeni përfaqësues fetarë, por i ftoj të gjithë anëtarët e KKSB-së gjatë 16 ditëve të aktivizimit gjatë dhunës me qenë bashkë para komunës. Aktivitetet që ndodhin brenda komunës, të gjitha aktivitetet, lajmërohen përmes faqes së komunës, ku ju mund të merrni informata.

Don Jeton Thaqi: Unë mendoj që është obligim dhe detyrë e Komunës, sikur e jona, me i ftuar edhe institucionet fetare me një letër zyrtare, qoftë edhe me një email, por jo me një prononcim që e bën komuna në faqen zyrtare. Mendoj që nuk është e mjaftueshme.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Don Jeton, hoxhë, pastor, vërejtje mëse me vend! Por ajo më e mira që mund të ju them është që këtu e keni shefin e kabinetit që merret direkt me këto dhe unë dua të delegoj detyrën që kësaj radhe Shemsia t'ju jap një përgjigje.

Z. Shemsi Bajraktari: Sa i përket ftesave, ne, çdo festë zyrtare e kemi publikuar në faqen e komunës. Po e marr me vend vërejtjen tuaj edhe është e rrugës që institucionet fetare t'i ftojmë me ftesë zyrtare, gjë të cilën herëve të tjera do ta kemi parasysh gjithsesi.

Nënkyetarja kaloi në pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika 2. Siguria në trafik.

Toger, z. Besnik Qupeva: Përshëndetje të pranishëm! Në kuadër të takimeve të rregullta të KKSBB-së, stacioni Policor vazhdimisht raporton në aspektin e sigurisë, ku do të raportojmë për muajin shtator, i cili ka qenë një muaj jashtëzakonisht dinamik, ku stacioni jonë ka regjistruar 91 raste. Të gjitha këto raste kanë qenë të menaxhueshme, pa dëme. Normalisht, shtatori është një muaj që ndryshon pak planin e ecurive operative të stacionit policor, sepse pas sezonës verore ku kemi shumë mërgimtarë, planet ndryshojnë. Konkretisht, aktivitetet tona thuajse të gjitha i kemi rreth shkollave, objekteve fetare, sigurisë në trafik dhe dhunës në familje.

Po ashtu, kërkim lëmosha shfaqet më shumë në muajin shtator, sepse kthehen nga vendet bregdetare. Policia ka vepruar vazhdimisht, ku ka shqiptuar gjoba ndaj shumë personave dhe qëndrojmë shumë mirë sa i përket kërkim lëmoshës. Siguria në trafik tanimë ka filluar me hartimin e planeve të reja, varësisht prej zonave ku ka pasur aksidente më shumë. Ashtu edhe janë paraparë pikat e kontrollit, ku policia i zbaton në përpikëri. Dhuna në familje në muajin shtator ka një rënje bukur të madhe, sepse gjatë sezonit veror kemi pasur një rritje të madhe, ku kryesisht kanë qenë mërgimtarët që e kanë shkaktuar dhunën në familje.

Kemi 91 raste të iniciuara nga 60 të vitit të kaluar; vepra penale 59 nga 34 vitin e kaluar; aksidente totale 32 me 26 të vitit të kaluar; me lëndime 6 me 6; aksidente me dëme 26 me 20; persona të lënduar 14 me 10. Tiketat kanë një rënje solide të numrit, ndërsa sa i përket numrit të arrestuarve ka një rënje solide, nga 41 që kanë qenë vitin e kaluar, në 32 këtë vit. Nëse ka dikush diçka, të urdhërojë.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, toger! Nëse ka dikush diçka tjetër?

Don Jeton Thaqi: E thatë që mërgimtarët e kanë shtuar numrin e dhunës në familje, është e vërtetë kjo?

Toger, z. Besnik Qupeva: Sezonin veror, numri i mërgimtarëve e dini që është bukur i madh dhe rastet kur të iniciohen, merret vendbanimi ku jeton. Shumica e rasteve janë persona që jetojnë jashtë Kosovës dhe rasti aty ku ndodh, aty regjistrohet.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Besoj që e keni vërejtur që në rrugët tona janë vendosur shenjat e reja të komunikacionit dhe këtë do ta vazhdojmë edhe në periudhat dhe kohët në vazhdim. Kur shohim nëse diçka që është dëmtuar ose nuk është vendosur, zakonisht kjo vjen edhe nga qytetarët. Nëse dikujt në Drejtorinë e Inspektoratit i ka ikur diçka, jam shumë e sigurt që ju do të jeni të ndërgjegjshëm, jo vetëm ju por edhe të gjithë qytetarët, të na mbani të informuar që ato t'i zëvendësojmë ose plotësojmë.

Z. Josip Dedaj: Faleminderit zv. kryesuese, përshëndetje për të gjithë! Janë tri pika që janë duke shkaktuar vetëm rreziqe në rrugë, por së pari duhet të falënderojmë Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Inspektoratit që i kanë vendosur shenjat të hekurudhat, por imbas fatalitetit që ka ndodh në Krushevë të Madhe ku kanë vdekur një çift bashkëshortor, në vitin 2013 ose 2014 ku

ka ndodhur një aksident i një familje 5 anëtarësh në Dush të Klinës, prej atëherë kur e kam ngritur si problem që hekurudhat duhet me u shenjëzuar me afërsi të hekurudhës dhe këtu më së paku 10 herë e kam përmend pa ndodhur aksidenti. Por falë Zotit, tash janë vendosur shenjat dhe është një siguri shumë më e madhe sesa ka qenë. Unë e kam lexuar në portale që ka qenë shenja "Stop", por që ajo shenja "Stop" nuk bën siguri para hekurudhës pa u vendosur shenjat paralajmëruese në 240 m në largësi, por është një sukses te drejtoria që e ka vendosur.

Nuk ka siguri tek shtyllat afër rrugës që janë vendosur deri te ura Pejë-Prishtinë, ku mbi 60% ato shtylla janë hequr. Çmimi i një shtylle ka qenë 240 euro, aty më së paku janë vendosur 1000 shtylla dhe janë hequr gjysma. Shumica janë hequr me aksidente, e disa janë larguar nga dikush që ka hapur biznes apo ku ta di. Por kryesorja mbi 50% janë hequr që ato shtylla kanë krijuar rrezik. E di edhe policia se sa shtylla kanë aksidentuar.

Pikën e tretë dua t'i drejtoj togerit: Sheshi i Ndue Përlleshit që kryesuesja thotë se janë vendosur shenja të reja, aty në hyrje të rrithit, dalja nga qendra në drejtim të Pejës, nuk ka kryqëzim të rrugës as s'ka pasur kurrë. Në tri udhëkryqet ka, nga lagja e "Sefermanve" ka, nga stacioni i autobusëve ka, edhe drejtimi i Pejës ka. Kryqëzimet në rrith, rrathi që del prej qendrës nga këtu ku jemi kurrë s'ka pasur kryqëzim rruge. Paramendo një aksident me fatalitet, eksperti kë do ta fajësojë? Gjithmonë kemi pasur pretime nga të gjithë që ajo ka me qenë punë e zgjidhur. Unë njëherë jam thirrur nga komisioni edhe aty e kemi cekë e kemi vizatuar me drejtorin e Inspektoratit, por nuk është vendosur. I ka 4 ose 5 vite që e kemi bërë atë.

Nuk mund t'u themi qytetarëve që kemi vendosur shenja të reja në Klinë kur qyteti i Klinës është pa shenja. Nuk ka parkingje, jemi duke parkuar kerret në rrugë, jemi duke pasur konflikte me njerëz. Ne që paguajmë tatim nuk kemi vend për automjetet tona! Faleminderit!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Fillimisht, rasti i parë që ka përfunduar me fatalitet edhe nga mediat edhe nga ekspertët, e kemi kuptuar që shenja ka qenë. Së dyti, shtyllat skaj rrugës, projekti që është bërë me shtylla gjatë rrugës ka qenë me inxhinierë që e kanë drejtimin e vet përkatës, profesionalistë në fushën e tyre, dhe e kanë parë si diçka të tillë. Kush jam unë, një gjuhëtarë me ju treguar se si duhet me u rregulluar kur paguhen ekspertët brenda komunës? Nën tre, te rrathi "Ndue Perlleshi" me siguri duhet me diskutuar se nuk kam informata, por ajo që është me kryesorja, që shenjat janë vendosur në komunën e Klinës dhe çdo njeri që ecën në këmbë ose me veturë, shenjat shihen në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit shumë sepse je në fushën që e njeh këtë temë shumë mirë dhe nuk e marr si një kritikë, por si një sugjerim që do e kemi parasysh.

Toger, z. Besnik Qupeva: Te pika e rrethrrrotullimit, je njohës i mirë i shenjave dhe i rregullave të trafikut. Stacioni policor në Klinë vazhdimisht e ka të angazhuar policin Luan Ahmetgjekaj sa i përket shenjave të trafikut, që bashkëpunon edhe me qytetarët dhe me inspektorët komunalë për të marr vendim se ku të vendosen/rivendosen shenjat. Ne ju ftojmë secilin që, nëse shihni diçka që nuk është praktike, ju ftojmë që ta paraqitni dhe ne t'i ndryshojmë.

Z.Josip Dedaj: Dua t'ju përgjigjëm të dyve. Në atë komision ku është Luani, jam edhe unë dhe kurrë s'na ka thirrur komisioni i komunës, vetëm njëherë kemi dal. Znj. Kryesuese, Nënkyetare e Komunës, shenja "stop" ka qenë te hekurudha, nuk ka qenë afërsia e hekurudhës dhe asnje shenje s'ka pasur te hekurudhat, tash janë vendosur. Unë jam shëtitur nëpër krejt vendkalimet e hekurudhave edhe kah Budisalci edhe ka Dushi. Tash janë shenjat, por kur ka ndodhur rasti, nuk kanë qenë.

Toger, z. Besnik Qupeva: Ti e di shumë mirë që vidhen shenjat, vidhen kapakët e kanalizimit. Ne tash punojmë në atë drejtim që të mund t'i vetëdijesojmë njërëzit, sepse shenjen e trafikut nuk mundesh me i ruajt. Shenjat janë vjedhur, Josip, janë hequr, janë thyer në shumë pika. Tash i kemi vendosur dhe kemi për të parë që pas pak kohe ne duhet t'i rivendosim prapë. Tek ne edhe treni gjuhet me gurë, gjë që s'është aspak normale, janë probleme të shoqërisë që po mundohemi çdo ditë t'i trajtojmë.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, toger! Atëherë kalojmë te pika e katërt e rendit të ditës.

Pika 4. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faktikisht, anëtarët e Këshillit për Siguri në Bashkësi jemi këta që jemi standard dhe as edhe njëherë, pos me kërkesën tuaj nëse vjen me shkrim, kemi të drejtë të ftojmë një drejtor tjetër që të jap ndonjë informatë shtesë. Përndryshe, anëtarët e KKSB-së e dini që janë të gjithë me pagesë dhe nuk kemi mundësi të shtojmë anëtarë të rinj. Unë përgjigjet i marr nga drejtorët ose nga përgjegjësit, por edhe në takimet që i kemi, unë, sot bisedova me përgjegjësin lidhur me këtë temë dhe ndoshta e kemi pak të përshtypuar si temë. Përndryshe, vitin e kaluar janë pastruar 150 km rrugë për gjatësi, por sivjet ende nuk kompani dhe kjo fillon 3 ose 4 ditë në kohën kur fillojnë të reshurat. Njëherë për njëherë është herët të diskutojmë se çka është bërë dhe se çfarë projekti ka. Pra, nga drejtoria përkatëse kam marrë arsyetimin se është ende herët për këtë temë.

Nëse dikush nuk ka diçka në pikën e fundit tek të ndryshme, atëherë e cilësoj këtë takim të myllur, duke ju falenderuar për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj.

Procesmbajtësja,
Orgeta Syla

Zv. KRYESUESJA,
Marqe Tanushi-Selmanaj

